


www.mzhe-ks.net

## Përmbajtja:



**TRANZICIONI I SEKTORIT TË ENERGJISË NË KOSOVË**



**DYFISHIMI I KAPACITETEVE PËR NGROHJEN QENDRORE**

KATEGORIA	PERIODA	APORTANCA E ENERJISË (TWh)
Kosovar Global	1.01 për derbën e termocentralit (2018)	18.5 (100%)
	2.01 për derbën e termocentralit (2023)	18.5 (100%)
	3.01 për derbën e termocentralit (2040)	18.5 (100%)
	4.01 për derbën e termocentralit (2060)	18.5 (100%)
Kosovar Global	1.01 për derbën e termocentralit (2018)	18.5 (100%)
	2.01 për derbën e termocentralit (2023)	18.5 (100%)
	3.01 për derbën e termocentralit (2040)	18.5 (100%)
	4.01 për derbën e termocentralit (2060)	18.5 (100%)

**MË SHUMË SE ENERGJI - FONDI PËR ZHVILLIMIN E KOMUNITETIT**



**TRAJNIMI: ZHVILLIMI I KAPACITETEVE PËR IMPLEMENTIMIN E MARRËVESHJEVE KOMERCIALE**

## TRANZICIONI I SEKTORIT TË ENERGJISË NË KOSOVË

Strategjia e Energjisë 2017-2026, e miratuar nga Kuvendi i Kosovës, përcakton objektivat për zhvillimin e sektorit të energjisë. Kjo strategji është e fokusuar në: zhvillimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, furnizimin e qëndrueshëm dhe të sigurt me energji për qytetarët, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe mbrojtjen e mjedisit.

Tranzicioni i energjisë në Kosovë është një proces shumë i rëndësishëm për vendin me qëllim të përmbushjes së objektivave strategjike dhe kriterëve të vendosura nga Bashkimi Evropian (BE). Në qendër të këtij tranzicioni është ndërtimi i Termocentralit "Kosova e Re", i cili siguron bazën e të ardhmes së sektorit të energjisë. Sigurimi i furnizimit me energji elektrike për Kosovën është kryekëput i lidhur me termocentralin Kosova e Re si opsioni më i lirë, i cili përveç koston përmbushë edhe standardet mjedisore.

Në përputhje me strategjinë e energjisë, zhvillimi i Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë (BRE) është qenësor për të ardhmen energjetike në vend. Gjithsesi, deri në kohën kur


BRE-të do t'i mbërrijnë qëllimet e synuara, "Kosova e Re" do të ofrojë siguri në furnizim me energji elektrike.

Kosova deri më tani ka zbatuar skemën përkrasë për të nxitur BRE-të përmes tarifave nxitëse për energji nga uji, era, dielli dhe biomasa. Kurse, tani po punohet për ristrukturimin e mbështetjes për BRE-të sipas kërkesave të Komunitetit të Energjisë. Ligjet e sektorit të energjisë, e veçanërisht Ligji për Energji, synon të optimizojë përdorimin e BRE-ve, përfshirë përcaktimin e qëllimeve gjeneruese vjetore dhe afatgjata, si dhe plasimin e tyre në treg. Në mënyrë që të promovohet përdorimi i BRE-ve, Ministria e Zhvillimit Ekonomik ka draftuar një Plan Veprimi 10-vjeçar që do ta ndihmojë Kosovën të arrijë qëllimet e caktuara nga Komuniteti i Energjisë për vitin 2020.

Ndërtimi i termocentralit "Kosova e Re" është në funksion të zhvillimit dhe ndërtimit të kapaciteteve të reja të BRE-ve, duke ofruar energji elektrike bazë, të sigurt dhe të qëndrueshme, si parakusht për ndërtimin e BRE-ve.

### SKENARI I MUNDSHËM I TRANZICIONIT PËR PRODHIMIN E ENERGJISË

Vizioni i Kosovës për transformimin e sektorit të energjisë



# DYFISHIMI I KAPACITETEVE PËR NGROHJEN QENDRORE



Kogjenerimi nënkupton gjenerimin e energjisë elektrike, duke përfshirë edhe energjinë termike, nga prodhimi i përbashkët nga termocentrali.


Me futjen në operim të termocentralit “Kosova e Re”, 10% e kapacitetit elektrik të saj do të jetë i gatshëm për kogjenerim, e cila do të mundësojë zgjerimin e rrjetit ekzistues dhe të përfshijë Komunën e Prishtinës, Obiliqit,

Fushë Kosovës, Vushtrrisë dhe Komunën e Drenasit.

Termocentrali “Kosova e Re” ka potencial gjenerimi për ngrohjen qendrore të barabartë me kapacitetet e termocentralit “Kosova B”, të konvertuar në energji termike ekuivalent prej 250 MWth secila. Kurse, planifikimi i dekomisionimit të termocentralit “Kosova A” nuk do të ndikojë në furnizimin me ngrohje qendrore.



**BROSHURA**



**FAKTET KRYESORE**



**PYETJET MË TË SHPESHTA**



# MË SHUMË SE ENERGJI

## - FONDI PËR ZHVILLIMIN E KOMUNITETIT

Një nga përftimet e menjëhershme nga termocentrali "Kosova e Re" është themelimi i Fondit për Zhvillimin e Komunitetit (FZhK) prej 10 milionë euro, të ndara nga investitori ContourGlobal. Ky fond do të disbursohet pas fillimit të ndërtimit për një periudhë 7 vjeçare. Investitori do të kontribuojë në gjashtë vitet e para me nga 1.5 milionë euro në vit, dhe 1 milion euro në vitin e shtatë.

FZhK do të përkrahë drejtpërdrejtë të prekurit nga projekti. Qëllimi është të ndihmojë komunitetet t'i përmirësojnë mjediset e tyre sociale, ta rrisë barazinë dhe drejtësinë sociale, të ndërtohen kapacitete dhe të përfshihet komuniteti në proceset vendimmarrëse që ndikojnë në përmirësimin e kushteve të tyre.

Fondi në veçanti do të përkrahë projekte që kanë për qëllim krijimin e vendeve të punës si kërkesë e drejtpërdrejtë e komunitetit gjatë fazës së konsultimit publik.

Qëllimet që fondi synon t'i arrijë: përfshijnë zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit përtej një gjenerate; zhvillim të planifikuar, monitoruar dhe vlerësuar mirë me dobi afatgjata; si dhe përkrah planet zhvillimore të qeverisjes vendore. Të deleguarit nga Qeveria dhe ContourGlobal bashkërisht do të përzgjedhin projektet që do të financohen nga Fondi për Zhvillimin e Komunitetit.

KONTRIBUAR NGA	PERIUDHA	REFERENCA E MARRËVESHJES SË PROJEKTIT	SHUMA
<b>Contour Global</b>	Në ose para datës së transferimit (afërsisht janar 2023)	SSA § 6.1	€1,500,000
	1 vit pas datës së transferimit (afërsisht janar 2024)	IA § 10.1 (a) (i)	€1,500,000
	2 vjet pas datës së transferimit (rreth janar 2025)	IA § 10.1 (a) (i)	€1,500,000
	3 vjet pas datës së transferimit (rreth janar 2026)	IA § 10.1 (a) (i)	€1,500,000
	4 vjet pas datës së transferimit (rreth janar 2027)	IA § 10.1 (a) (i)	€1,500,000
	5 vjet pas datës së transferimit (rreth janar 2028)	IA § 10.1 (a) (i)	€1,500,000
	6 vjet pas datës së transferimit (rreth janar 2029)	IA § 10.1 (a) (ii)	€1,000,000
<b>TOTALI</b>			<b>€10,000,000</b>





# TRAJNIMI: ZHVILLIMI I KAPACITETEVE PËR IMPLEMENTIMIN E MARRËVESHJEVE KOMERCIALE



Qeveria e Republikës së Kosovës, në përputhje me obligimet kontraktuale të marra me nënshkrimin e Marrëveshjeve Komerciale për ndërtimin e termocentralit "Kosova e Re", në maj të viti 2018 ka themeluar Ndërmarrjen e Re Energjetike të Kosovës (NKEC), ndërmarrje kjo e cila do të jetë drejtpërdrejt përgjegjëse për zbatimin e marrëveshjes për Blerje të Energjisë.

Anëtarët e Bordit të Përkohshëm të Drejtorëve të kësaj ndërmarrje janë njohur për së afërmi me procesin e zbatimit

të Marrëveshjeve Komerciale për termocentralin "Kosova e Re" gjatë një punëtorie pesëditore. Punëtorja u ka ofruar njohuri përbajtëse për rolin dhe përgjegjësitë e NKEC-it, përfshirë rekomandimet dhe këshillat për zbatimin sa më të mirë të këtyre obligimeve.





Kjo punëtori ka përmbyllur serinë e punëtorive për zhvillim të kapaciteteve për zyrtarët e Qeverisë së Kosovës dhe ministrive relevante, divizioneve, agjencive, dhe kompanive publike.

## DOKUMENTET E PROJEKTIT

Më shumë informata për TC "Kosova e Re" mund të gjeni në linqet më poshtë përmes dokumenteve si Marrëveshjet Komerciale, Broshura, Fakte Kryesore, Pyetje të Shpeshta, uebfaqe dhe rrjete sociale.






- ▶ [Marrëveshja për Blerje të Energjisë](#) 
- ▶ [Marrëveshja e Zbatimit](#) 
- ▶ [Marrëveshja për Mbështetje të Sponsorit](#) 
- ▶ [Marrëveshja për Bartjen e Lokacionit](#) 

- ▶ [Marrëveshja e Largimit të Hirit dhe Gjipsit](#) 
- ▶ [Marrëveshja për Furnizim me Linjit](#) 
- ▶ [Marrëveshja për Kyçe](#) 
- ▶ [Marrëveshja për Furnizim me Ujë](#) 

### LINQET

- ▶ [Ministria e Zhvillimit Ekonomik](#) 
- ▶ [TC "Kosova e Re"](#) 
- ▶ [Strategjia e Energjisë](#) 

### MEDIAT SOCIALE

- ▶ [Facebook](#) 
- ▶ [LinkedIn](#) 
- ▶ [Twitter](#) 

## DOKUMENTET



BROSHURA



FAKTET KRYESORE



PYETJET MË TË SHPESHTA



QEVERIA E REPUBLIKËS SË KOSOVËS  
Ministria e Zhvillimit Ekonomik

Tel. 038 200 215 83  
[www.mzhe-ks.net](http://www.mzhe-ks.net)

### ADRESA:

QEVERIA E KOSOVËS  
MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK  
SHESI "ZAHIR PAJAZITI", NR.36  
10000 PRISHTINË, REPUBLIKA E KOSOVËS